



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 32 Datë 09.02.2018**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË  
“AGE SUNPOWER” SH.P.K, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT  
TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA IMPIANTI FOTOVOLTAIK TOPOJË (SHEQ  
MARINAS) ME FUQI TË INSTALUAR 1998 KW.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 4, pika 1, gërma “a”; neni 5, pika 1 gërma “a”; neni 10, pika 1 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016; nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 09.02.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për Licencimin e Shoqërisë “AGE SUNPOWER” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik Topojë (Sheq Marinas) me fuqi të instaluar 1998 KW,

**Konstatoi se:**

- Me shkresën nr.110 Prot, datë 26.01.2018, shoqëria “AGE SUNPOWER” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë (Sheq Marinas).
- Në datën 12.10.2017, është lidhur Kontrata me nr. 2272 Rep. dhe 1051/3 Kol, “Për ndërtimin shfrytëzimin dhe administrimin e Centralit Fotovoltaik “Topojë” me kapacitet të instaluar 1998 KW; në zonën Sheq-Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier, midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Mbajtësit të miratimit përfundimtar, shoqërisë “AGE Sunpower” sh.p.k.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me miratimin përfundimtar nr. 5789/2, datë 11.09.2017, ka miratuar ndërtimin e Centralit Fotovoltaik Topojë në favor të “AGE

Sunpower” sh.p.k, me fuqi të instaluar 1998 KW, në koordinatat e përcaktuara në nenin 3 të Kontratës sipërcituar.

- Aplikimi i shoqërisë “AGE SUNPOWER” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” si më poshtë:
  - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.4.1 4.4.2, 4.4.3 (gërmat “a”, “c”, “d”); 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2 gërma “d”, (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë);
- Nenin 9 pika 4.4.3 gërma “b” (dokumentacioni teknik dhe grafik); do të njoftohet subjekti që t’i plotësojë ato brenda afateve që përcakton “Rregullorja për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike.”

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AGE SUNPOWER” sh.p.k, për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltai Topojë (Sheq Marinas) me fuqi të instaluar 1998 KW.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**